

Prishtinë, Kosovë

25 gusht 2017

Drejtuar: Rrahim Pacollit, Byroja Kosovare e Sigurimit**Nga:** OJQ Germin**Tema:** Sigurimi Kufitar për mërgimtarët: Pse?

I nderuari zotëri Pacolli,

Më 30 qershor 2017, organizata jo-qeveritare Germin, në kuadër të iniciativës *Dialogu i Strukturuar për të Drejtat e Diasporës* (www.diasporaflet.org) ka mbajtur takimin virtual (Google Hangout) me temën *Sigurimi kufitar për mërgimtarët: Pse?*. Në këtë takim ishin prezent:

1. Bekim Dalipi, gazetar në Albinfo.ch, Zvicër.
2. Adelina Dakaj, juriste dhe aktiviste rinore, Gjermani.
3. Daut Haxhaj, aktivist, Norvegji.
4. Përparim Avdili, politikan dhe ekonomist, Zvicër.
5. Fjolla Vukshinaj, Koordinatore në nismën Dialogu i Strukturuar për të Drejtat e Diasporës, Kosovë.
6. Kushtrim Ahmeti, gazetar në Kohavision, Kosovë.

Diskutimi u moderua nga Lavdi Zymberi, hulumtuese dhe konsulente në OJQ Germin.

Pasi që çdo vit kemi fluks të madh të mërgimtarëve që hyjnë në Kosovë dhe të cilët duhet të paguajnë sigurim kufitar shtesë, ka indikacione se taksimi përmes policës kufitare paraqet pakënaqësi tek kjo pjesë e popullsisë. Kjo sepse përkundër shumë paralajmërimeve, Kosova ende nuk është përfutuese e Marrëveshjes për Kartonin e Gjelbër. Prandaj, marrë parasysht kostot ekonomike, politike e sociale në lidhje me sigurimin kufitar ndaj mërgimtarëve, organizata Germin hapi një debat në lidhje me shqetësimet dhe mundësitë që mundet Kosova t'i shfrytëzoj deri në anëtarësimin në Këshillin e Byrove të Sigurimit Kufitar.

Sipas panelit diskutues, barrierat sistematike dhe burokratike që po e përcjellin Kosovën dhe në veçanti po i prekin mërgimtarët në lidhje me sigurimet kufitare, është si pasojë e neglizhencës së institucioneve publike dhe kompanive të sigurimit në Kosovë.

Duke u bazuar nga të dhënat e botuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) në Buletinet Statistikor, kemi një rritje shkallore të numrit të policave kufitare nga viti 2002. Ndërsa është një sh'përputhje në lidhje me atë se sa kanë paguar mërgimtarët dhe dëmëve të paguara. P.sh në vitin 2014 janë shitur 488 mijë polica kufitar, në vlerë 14 milionë e 600 mijë, kurse dëmet e paguara janë 1 milionë e 300 mijë.

Për këtë, ne po ju dërgojmë disa nga rekomandimet e dala nga ky diskutim, të cilat mund të ju ndihmojnë në procesin e shqyrtimit të politikave për sigurimin kufitar.

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI:

1. Të nënshkruhen marrëveshje bilaterale me shtetet e caktuara, ashtu siç ka vepruar Kosova me Serbinë, Shqipërinë dhe Maqedoninë dhe mërgimtarët që vijnë nga shtet me më së shumti diasporë (*Zvicër, Gjermani, Austri, shtet Nordike*) të lirohen nga pagesa e policës kufitare.
2. Kosova të lidh memorandum me Shqipërinë që Kosova të hyjë në kuadër të Kartonit të Gjellbër me këtë shtet.
3. Të bëhen transparente paratë e mbledhura nga policat kufitar në uebfaqen e Byros së Sigurimeve Kosovare. Po ashtu, kjo platformë t'i përditësojë gjatë gjithë kohës informatat në lidhje me anëtarësimin e Kosovës në Karton të Gjellbër.

FONDI:

1. Të krijohet një fond nga Qeveria e Kosovës i cili merret me pagesat e policave kufitare apo të dëmeve të shkaktuara.
2. BKS të vë në dispozicion një pjesë të të hyrave nga shuma e premive për qëllime humanitare.
3. BSK të ndjek rrugën e anëtarësimin të Kosovës në organizata të tjera, të cilat kanë kriter anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe të pranohemi në Kartonin e Gjellbër. P.sh Banka Qendrore e Kosovës, apo anëtarësimi në FIFA.
4. Kosova të lidh memorandum me Shqipërinë që Kosova të hyjë në kuadër të Kartonit të Gjellbër me këtë shtet.
5. Kompanitë e sigurimeve në Kosovë t'i pranojnë dëshmitë e kompanive të tjera të sigurimeve në Europë të cilat garantojnë se do t'i mbulojnë të gjitha dëmet e shkaktuara në Kosovë.

PAGESAT:

1. BKS të mundësoj pagesat e policave kufitare online.
2. Pagesat të bëhen në shtetet nga nisen dhe të jepet mundësia të bëhet për një periudhë gjashtë mujore apo 1 vjeçare.
3. Pagesat të bëhen gjatë qëndrimit të mërgimtarëve në Kosovë në njërin nga kompanitë e sigurimit dhe jo në pikat kufitare.

Prandaj, duke marr parasysh që mërgata shqiptare përbën një prej grupeve më të mëdha sociale në Kosovë, lehtësimi mbi sigurimet kufitare është i rëndësishëm.

Në vazhdimësinë e aktiviteteve për ta ngritur zërin e diasporës për të drejtat e tyre politike e sociale, Germin është duke u takuar me bashkatdhetarët tanë në disa shtete të botës, për të marrë informata të hollësishme për mendimet dhe perceptimet e diasporës. Andaj, duke marr parasysh që diaspora gjithmonë ka qenë një faktor i rëndësishëm për të mbledhur përkrahje ndërkombëtare për Kosovën si dhe duke investuar për përmirësimin e shoqërisë kosovare, Germin do të krijojë Grupin Avokues të Diasporës. Qëllimi i këtij grupi joformal është të bashkëpunojë me institucionet publike të Kosovës për të avokuar mbi temat që lidhen me interesat dhe të drejtat e tyre në vendin amë, sikurse edhe kjo temë.

Shpresojmë që pikat e përmendura më lartë do të hapin një diskutim më të gjerë rreth sigurimit kufitar.

Të bashkangjitur gjeni editorialin e hartuar nga Kaltrina Kusari nga OJQ Germin me titullin [Sigurimi kufitar për mërgimtarët: Manifestim i neglizhencës së institucioneve kosovare.](#)



tel.: +386 (0) 49 564 100 | e-mail: info@germin.org
address: st.Tringë Smajli, 5th floor, no.48 | 10000 Pristina, Kosovo
www.germin.org

Me respekt,

Liza Gashi

Drejtoreshë e Programeve në Germin

